

# EPOKA E RE E SKANIMIT TË THJESHTË DHE TË SIGURT PA DRAJVER

Canon imageFORMULA DR-S350NW është një skaner A4 tryeze i fuqishëm, i krijuar për të mbështetur punën hibride, me skanim të lehtë dhe të thjeshtë që mundësohet falë skanimit pa drajver në ueb dhe lidhshmërisë për skanim të drejtpërdrejt të punës.

 imageFORMULA  
DR-S350NW



## DR-S350NW

EKRAN I MADH ME NGJYRA DHE  
ME PREKJE ME SKANIM NË UEB

SHPEJTËSIA E SKANIMIT  
50PPM / 100IPM

VETËMBUSHËSJA E DOKUMENTEVE:  
60 FLETË

VOLUMI I SUGJERUAR DITOR  
DERI NË 9000 SKANIME

## PËRFITIMET

- Skanim i thjeshtë, pa problem me shfletues uebi dhe skanim i drejtpërdrejtë i punës përmes përdorimit të aplikacionit të integruar të uebit Canon dhe komoditetit të skanimit pa drajver, i cili ju kursen kohë dhe përpjekje pa qenë nevoja që të lidheni me një kompjuter.
- Përshtatje dhe lidhshmëri fleksibël me ndërfaqe të zgjedhura USB, LAN dhe/ose WiFi. Funksionon me një larmi pajisjesh dhe sistemesh operative dhe dërgon imazhe në disa lloje të ndryshme të destinacioneve dalje.
- Përdorim intuitiv dhe i përshtatshëm për përdoruesin falë ekranit të madh me ngjyra dhe me prekje dhe ikonave të paracaktuara të profileve të punës me imazhe dhe meny të animuara të ndihmës për ta bërë funksionimin të lehtë për të gjithë.
- Siguri më e lartë për qetësinë tuaj mendore, me akses të përdoruesit dhe kontrollë për vënien e kufizimeve, enkriptim dokumentesh dhe masa të qëndrueshme për lidhjen me pajisjet dhe në rrjet.
- Kurseni kosto dhe kohë falë përpunimit të avancuar të imazhit, duke përfshirë OCR, skanimit produktiv dhe të besueshëm me shpejtësi të lartë dhe mjeteve të menaxhimit të pajisjes.
- Reduktoni ndikimin mjedisor. Mbështetni mjedisin duke përdorur këtë pajisje shumë të qëndrueshme me konsum të ulët të energjisë, të certifikuar nga EPEAT Gold\*.

Certifikim EPEAT Gold\*



# PËRDORIM I THJESHTË DHE FLEKSIBËL, SI DHE LIDHJE E SIGURT.

## FUNKSION I LEHTË I SKANIMIT NË UEB PËR LIDHJE TË MENJËHERSHME

Kurseni kohë dhe përpjekje falë skanimit të thjeshtë në shfletues uebi. Përdoruesit në të njëjtin rrjet mund të lidhin në çast pajisjet e tyre celulare me skanerin, thjesht duke skanuar kodin QR në ekranin e skanerit për të hapur softuerin e integruar CaptureOnTouch Lite Web dhe për të filluar me skanimin e tij - Kaq e thjeshtë është! Ose, lidhuni nëpërmjet kompjuterit ose laptopit tuaj Mac për të përfituar nga funksionet e lehta të skanimit në ueb dhe të shmangni nevojën për të instaluar softuerë apo drajvera shtesë.

## FUNKSION I DREJTPËRDREJTË I SKANIMIT TË PUNËS NË VENDNDODHJE TË NDRYSHME

Pajisja DR-S350NW mbështet gjithashtu skanimin e drejtpërdrejtë pa nevojën e një kompjuteri apo softueri shtesë. Për të dërguar skedarë drejtpërdrejt përmes rrjetit në destinacionin dalës, përdorni opsionet e paracaktuara të skanimit që përmban pajisja për të gjitha detyrat rutinë të proceseve të punës. Pajisja mbështet dërgimin e skedarëve të skanuar në dosje, adresa emaili, printera dhe serverë FTP (FTP/FTPS/SFTP) të përbashkët. Me funksionin skanim-postë, përdoruesit mund të dërgojnë gjithashtu imazhe në Teams ose Slack për të përmirësuar bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit.

## PËRDORIM INTUITIV

Paneli i madh i ekranit 4,3" me ngjyra dhe me prekje ofron shikueshmëri të qartë të të gjitha punëve të skanuara dhe të parametrave të tjerë dhe përdoruesit mund të shikojnë paraprakisht imazhet e skanuara përpara se ato të dërgohen për të përmirësuar saktësinë dhe për të kursyer kohë. Ndihma e shpejtë është e disponueshme përmes imazheve dhe udhëzimeve të animuara GIF dhe ndërfaqja e përdoruesit mund të personalizohet për proceset individuale të punës.

## LIDHSHMËRI FLEKSIBËL

Skaneri DR-S350NW ka ndërfaqe USB, LAN dhe WiFi (2.4 GHz / 5 GHz) dhe mbështet përdorimin me lloje të ndryshme pajisjesh, duke përfshirë kompjuter, Mac Book, Chromebook dhe pajisje inteligjente (Android dhe iOS). Gjithashtu, skaneri është i certifikuar sipas Mopria® dhe mund të përdoret me Chrome OS pa qenë e nevojshme të instalohet një drajver apo aplikacion. Ideal për shpërndarje të lehtë dhe përdorim fleksibël në të gjitha llojet e ambienteve të punës dhe punë skanimit.

**Canon**



DOSJE E  
PËRBASHKËT



POSTA



PRINTERI




FTP



FTPS



SFTP



## SKANIM I SIGURT

Parandaloni aksesin e paautorizuar në skaner ose përdorimin e veçorive të zgjedhura falë gamës së metodave të verifikimit dhe kontroleve për vendosjen e kufizimeve. Çaktivizoni lidhje të ndryshme, si p.sh., me WiFi, nëse është e nevojshme, dhe pajisja mbështet protokolle të ndryshme sigurie, duke përfshirë WPA3 dhe rrjetet që kanë nevojë për 802.1X. Pajisja mbështet shtimin e kontrollit të enkriptimit të fjalëkalimit të dokumentit për të garantuar se vetëm personat e autorizuar të mund të kenë akses në informacion.



## CILËSI DHE PRODUKTIVITET SUPERIOR

Krijoni imazhe me cilësi të lartë të vazhdueshme duke skanuar të gjitha llojet e dokumenteve falë Active Threshold dhe mjeteve të tjera të përparuara të imazhit. Me mekanizmin e fuqishëm të furnizimit për ngarkesa të mëdha, ju mund të skanoni lloje të ndryshme dokumentesh në mënyrë të besueshme, duke përfshirë pasaporta dhe karta identiteti. Kurseni kohë me shpejtësi të larta printimi deri në 100 imazhe në minutë dhe merrni përsipër ngarkesa më të larta pune me një pajisje që ofron volum skanimi ditor të sugjeruar deri në 9000 skanime/ditë.

## SOFTUER I FUQISHËM ME OCR

CaptureOnTouch Pro është një softuer skanimi për PC i cili ofron një ndërfaqe të lehtë për përdoruesin përmes operimit të thjeshtë me anë të ikonave, si dhe ofron mjete të fuqishme për përpunimin e dokumenteve. Konfiguroni punët për të ruajtur formate të ndryshme, duke përfshirë PNG, JPEG, TIFF, BMP, PPTX, Word\*, Excel\* dhe PDF. Mbështet leximin e OCR, barkodeve dhe kodeve 2D, dhe skedarë indeksesh të dhënash dalëse për integrimin e lehtë në flukset e punës ekzistuese dhe sisteme të menaxhimit të dokumenteve.

## KURSENI KOSTOT E PËRDORIMIT

Mjete praktike menaxhimi qendror për të mbështetur biznesin tuaj dhe mjedisin e përdoruesit.

- **Menyja e uebit:** Metodë e lehtë për menaxhimin e parametrave për një numër të vogël skanerësh.
- **Mjeti i menaxhimit të skanerit DR:** Metodë efikase për të monitoruar dhe shpërndarë parametra në të njëjtën kohë, për një numër të madh skanerësh në organizatë.
- **COT Admin:** Zgjidhje e bazuar në server për të menaxhuar profilet e përdoruesve, proceset e punës me Active Directory dhe mbështet përdorimin e kartës së jashtme NFC për verifikimin e identifikimit.

## REDUKTONI NDIKIMIN NË MJEDIS

Mbështetni mjedisin duke përdorur këtë pajisje shumë të qëndrueshme me konsum të ulët të energjisë, të certifikuar nga EPEAT Gold\*. Është e mbushur me materiale të ripërdorshme dhe është ndërtuar me një nivel të lartë të plastikës së ricikluar.

Certifikim EPEAT Gold\*



**Canon**

# SPECIFIKIMET TEKNIKE

## SPECIFIKIMET E PRODUKTIT

Tipi	Skaner me mbushje fletësh dyanëshe, tipi për tryezë
Njësia e sensorit të skanimit	CIS
Rezolucioni optik	600 dpi
Burimi i dritës	LED RGB
Ana e skanimit	Para/mbrapa/dyanëshe
Paneli i përdoruesit	Ekran me ngjyra dhe me prekje - 10,9 cm (4,3")
Ndërfaqja	USB: USB3.2, Gen1, Ethernet: 1000 Base-T/100 Base-TX/10 Base-T Wi-Fi: 802.11 b, g, n (2,4 GHz) / 802.11 a, ac (5 GHz) Pritës USB: USB2.0 Tipi A (Vetëm për lexues të jashtëm NFC)
Përmasat (gjjer.xthell.xlart.)	Sirtari i mblyllur: 291 x 267 x 242 mm
Pesha afro	3,4 kg
Nevojat për energji	AC 220 - 240V (50/60 Hz)
Konsumi i energjisë	Skanimi: 28 W ose më pak   Në modalitetin e fjetjes: 2,0 W   I fukur: 0,3 W ose më pak
Mjedisi i përdorimit	Temperatura: 10 - 32,5 °C Lagështia: 20% deri në 80% lagështi relative (RH)
Pajtueshmëria mjedisore	Produkti: EPEAT Gold <sup>2</sup> , Energy STAR <sup>3</sup> , RoHS Prodhuesi: Certifikim ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, ISO 13485, ESG (SGS)

## SPECIFIKIMET E SKANIMIT

Bardhezi	50 ppm / 100 ipm (200 dpi/300 dpi)
Ngjyra	50 ppm / 100 ipm (200 dpi) 40 ppm / 80 ipm (300 dpi)
Rezolucioni në dalje	100/150/200/240/300/400/600/1200 dpi
Modaliteti në dalje	Me ngjyra / Gri/ Bardhezi
Volumi i këshilluar ditor	nga 6.000 në 9.000 skanime/ditë

## SPECIFIKIMET PËR DOKUMENTET

Cjerësia	50,8-216 mm
Cjatësia	54-356 mm
Trashësia	27 g/m <sup>2</sup> - 255 g/m <sup>2</sup> (0,04 - 0,3 mm)
Modaliteti i dokumenteve të gjata	Deri në 5588 mm
Skanimi i kartëvizitave	Gjerësi: 50 - 55 mm / Gjatësi: 85 - 91 mm / Trashësi: 128 - 255 g/m <sup>2</sup> (0,15 - 0,3 mm)
Skanimi i kartave plastike	Gjerësi: 86 mm / Gjatësi: 54 mm / Trashësi: 1,4 mm ose më pak (Mbeshteten kartat me relief)
Pasaportë	Deri në trashësi 4,0 mm (me fletë mbajtëse)
Ndarja e letrës	Metoda me rul ngadalësues
Kapaciteti i vetëmbushësës (80 g/m <sup>2</sup> )	60 fletë (A4)

## VEÇORITË E VEÇANTA

Skanim në ueb (pa drajver)	Skanim në shfletuesit e uebit me çdo pajisje në të njëjtin rrjet me anë të aplikacionit të integruar të uebit CaptureOnTouch Lite Web (Mbeshtet lidhjen përmes skanimit të kodit QR, njohjen OCR, zbulimin ultrasonik të furnizimit të dyfishtë, modalitetin e pasaportës, anashkalimin e faqeve bosh, zbulimin automatik të përmasave të faqes, mbrojtjen e fjalëkalimit)
Skanim i drejtpërdrejtë (pa drajver)	Skanim i drejtpërdrejtë i punës nga paneli për funksionim të pavarur. (Skanim në dosjen e përbashkët, FTP/FTPS/SFTP, postë, printer. Mbeshtet njohjen OCR, pamjen paraprake të imazhit, zbulimin ultrasonik të furnizimit të dyfishtë, modalitetin e pasaportës, anashkalimin e faqeve bosh, zbulimin automatik të përmasave të faqes)

Parametrat (me drajver)	Zbulimi ultrasonik i furnizimit të dyfishtë, zbulimi automatik i ngjyrave, anashkalimi i faqeve bosh, zbulimi automatik i madhësisë së faqes, cilësimi automatik i rezolucionit, zbulimi i orientimit të tekstit, njohja e barkodit/kodi 2D, njohja OCR, ndarja në grupe, prag aktiv, përmirësimi i tekstit (I/I), drejtimi, lëshimi i furnizimit të dyfishtë, skanimi paraprak, korrigjimi 3-dimensional i ngjyrave, parandalimi i tejkalimit të kontureve/heqja e sfondit, zbutja e sfondit, theksimi i karaktereve, heqja/përmirësimi i ngjyrave (RGB), funksioni MultiStream, parametrat e rregullueshme të veçorisë gamma, reduktimi i Moire, modaliteti me format të madh, rregullimi i raportit të reduktimit, kontrasti bardhezi, imazhi i kundërt, sistemi i rikthimit të shpejtë.
-------------------------	---

## PROGRAMET E PËRFSHIRA KOMPJUTERIKE

Windows	Drajver ISIS, TWAIN dhe WIA / CaptureOnTouch Pro / Mjeti i parametrat të softuerit drejtues Canon imageFORMULA / Mjeti i parametrat IEEE 802.IX, / Mjeti i menaxhimit DR (vetëm me shkarkim) / Mjeti i administratorit CoT (vetëm me shkarkim)
Mac	Drajver TWAIN, CaptureOnTouch
Tjetër	CaptureOnTouch Lite Web (aplikacion uebi i integruar në pajisje) Mbështet Chrome OS dhe i certifikuar për skanim nga Mopria

## PJESËT E KONSUMIT DHE OPSIONET

PJESËT E KONSUMIT	Set ruli ndërrimi
AKSESORËT	Njësia e skanerit me shtrat të sheshtë 202 (A3) Njësia e skanerit me shtrat të sheshtë 102 (A4) Fletë mbajtëse A4 Fleta mbajtëse e pasaportës

Shënimi në fund të faqes:

<sup>1</sup> Mund të ketë kufizime gjeografike në varësi të rajonit. Kontrolloni me zyrën tuaj lokale të "Canon" për disponueshmërinë e pajisjes.

Të gjitha të dhënat bazohen në metodat standarde të testimit nga Canon përveç ku tregohet ndryshe. Objekt i ndryshimeve pa njoftim paraprak.

## OPSIONET



### Njësi skaneri 102 e shtrirë A4

### A3 Flatbed Scanner Unit 202

**SKANERË OPSIONALE ME SHTRAT TË SHESHTË A3 dhe A4**  
Skanoni libra të lidhur, periodikë dhe materiale delikate duke shtuar njësinë 102 të skanerit me shtrat të sheshtë A4 ose njësinë 202 të skanerit me shtrat të sheshtë A3. Me lidhjen përmes USB-së, këta skanerë të shtrirë punojnë më së miri bashkë me skanerët Canon ADF.

### INTEGRIM I PERSONALIZUAR

Integroni aplikacionin e uebit me CaptureOnTouch Lite Web SDK, përdorni mjedin për të personalizuar ndërfaqen e përdoruesit të skanerit dhe për të marrë akses në paketat e tjera të zhvilluesve të softuerit dhe API-të përmes Programit të Zhvilluesve të Canon. Për të zbuluar më shumë regjistroni këtu: <https://developers.canon-europe.com>

## MOHIMI I PËRGJEGJËSISË

Të gjitha të dhënat bazohen në metodat standarde të testimit nga Canon përveç ku tregohet ndryshe. Shpejtësia e skanimit mund të ndryshojë në varësi të mjedisit kompjuterik, parametrave të skanerit dhe faktorëve të tjerë. Ka kufizime në veçoritë në dispozicion sipas softuerit, drajverit dhe sistemit operativ të përdorur. Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim. Vizitoni faqen e internetit të Canon për më shumë informacion. Canon dhe logoja e Canon janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Canon Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe mund të jenë gjithashtu marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara në shtete të tjera. imageFORMULA është një markë tregtare e CANON ELECTRONICS INC. Microsoft, Windows, Microsoft Edge dhe Microsoft Teams janë marka tregtare të regjistruara ose marka tregtare të Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera. Mac, Mac OS, macOS dhe Safari janë marka tregtare të Apple Inc. të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera. Slack është një markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Slack Technologies, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera. Google Chrome, Chrome OS dhe Android janë marka tregtare të regjistruara ose marka tregtare të Google LLC. QR Code është një markë tregtare e regjistruar e DENSO WAVE INCORPORATED në Japoni dhe në shtete të tjera. ISIS është një markë tregtare e regjistruar e OpenText në Shtetet e Bashkuara.

Canon Electronics Inc.  
canon-elec.co.jp

Canon Europe  
canon-europe.com

Albanian edition  
© Canon Europa N.V., 2024